



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 2/14

Prishtinë, më 23.12.2014, ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Bojan Mitić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi dhe Jakup Krasniqi.

Mungoi. Fikrim Damka.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Avdullah Hoti-Ministër i Financave, Agim Krasniqi-Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Rustem Berisha-Deputet, Lumnije Murati-ZPRK, Petrit Hysaj-OSBE, Jetmir Bajra –KDF, Argjent Zeqiria-Ass i GP AAK, Ramadan Islami nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashuriye Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari – në takimin e sotëm do të shqyrtohet pjesa tekstuale e projektligjit, ndërsa në takimin e nesërm që do të mbahet, pjesa tabelare dhe ajo që ka të bëjë me kërkesat buxhetore dhe amendamentet.

Besa Gaxherri – situata për shqyrtimin e projektbuxheti është shumë e përsheptuar dhe e komplikuar. Duke ditur urgjencën në shqyrtimin e këtij projektligji, unë mendojë që është problem me i shqyrtue të gjitha kërkesat buxhetore, dhe ne duhet të orientohejmë në punën e përbashkët me ministrinë e financave, dhe të shohim se çfarë kursime mund të bëjmë, duke pasur parasysh se ministria ka mundur të bëjë më shumë analiza, ndoshta në mallra dhe shërbime diçka, përndryshe është problem në këtë kohë të shkurtër, që të merremi me shqyrtimi e të gjitha këtyre kërkesave dhe amendamenteve.

Avdullah Hoti – njoftoi se si ministri, i kemi disa propozime tek pjesa tekstuale, po ashtu kemi punuar edhe në pjesën e kursimeve të mundshme dhe do ti kemi disa propozime në pjesën tabelare, duke mos prekur asnjëherë kualitetin e shërbimeve, as në arsim e as në shëndetësi dhe në fushat tjera. Për të gjitha organizatat buxhetore propozojmë që së paku për gjashtë muajt e parë të vitit të ardhshëm, ti ndalim blerjen e veturave të reja, blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative. Po ashtu janë disa projekte

kapitale në disa organizata të cilat duhet me u përgatit leja ndërtimore, ndarja e lokacioneve, ne do i mbajmë kodet buxhetore për ato projekte do ti destinojmë mjetet nëpër pozicione tjera.

Kryetari – është bërë një gabim teknik, në shkurtesën që i referohet Sistemit Informativ të Menaxhimit të Financave Publike, dhe fjala “SMIFK”, duhet të zëvendësohet me fjalën “SIMFK”

Komisioni, njëzëri, vendosi që në tërë tekstin e projektligjit, fjala “SMIFK”, zëvendësohet me fjalën “SIMFK”

Kryetari – paragrafi 2 i nenit 9, dhe është fjala për financimin e RTK-së është për diskutim. Në tekst përmendet periudha tre vjeçare e financimit të RTK-së nga buxheti, dhe ne e dimë që kjo periudhë kalon në muajin maj dhe nuk mund të lëmë në këtë formë mënyrën e financimit të RTK-së.

Avdullah Hoti - ne e dimë se RTK nuk i ka përfillur rregullat e reklamimit dhe nuk ka qenë e disiplinuar sa i përket inkasimit të të hyrave prej reklamave komerciale dhe kanë performuar si çdo televizion tjetër privat.

Safete Hadergjona - çështja e Radiotelevizionit të Kosovës është një problem që po na përcjell prej vitit në vit. Ne si komision jemi përpjek me e fut në sistem, ku e kemi obliguar RTK-në, që çdo tre muaj më na dërgue raportin e shpenzimeve dhe të hyrave, në detale dhe kemi arritur deri diku njëfarë rregulle, por prapë rezultatet nuk janë në nivelin e duhur. Në ligjin e RTK-së është paraparë përqindja e financimit të RTK-së prej 0.7%, dhe periudha trevjeçare, dhe kjo periudhë është në prag të kalimit dhe tani për ta ndryshuar 0.7%, duhet ndryshuar edhe ligjin bazik. Prandaj, në këto rrethana që jemi, ne nuk kemi mundësi me ndryshue ligjin e RTK-së dhe le të mbetet 0.7% për vitin 2015 dhe të angazhohemi që të gjindet mënyra afatgjate e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe jo më prej buxheti të Kosovës.

Jakup Krasniqi – nëse është përcaktuar periudha kohore e financimit me ligj dhe kjo periudhë kalon në tre muajt të parë të vitit, nuk mundet që të vazhdohet me formën e njëjtë ligjore të financimit. Ka qenë në përgjegjësinë e RTK-së, që të njoftohet Kuvendi për përfundimin e periudhës kohore të financimit të RTK-së prej buxhetit. Ligji ka përcaktuar kohën e financimit dhe ne nuk mund të veprojmë ndryshe sepse do të ishte jashtë ligjore.

Besa Gaxheri – pa marrë parasysh si është paraparë në ligjin e RTK-së, mjetet për çdo organizatë buxhetore, në këtë rast përqindja, rishikohen çdo vit.

Kryetari – çështja e referimi në ligjin e RTK-së duhet të riformulohet.

Bardhyl Meta – duhet shikuar neni prej zyrës ligjore, por duhet trajtojmë edhe vërejtjet tona për punën e RTK-në që janë të shumta, prej atyre politike, redaksionale, të punësimit, buxhetit, dhe mënyrës së menaxhimit, etj. Ne duhet tani të trajtojmë dhe rregullojmë pjesën ligjore të financimit sipas ligjit në fuqi, por duhet të kërkojmë edhe raportin financiar për të parë nivelin menaxhimit të mjeteve të këtij mediumi dhe mbi bazë të këtyre fakteve, ti propozojmë parlamentit, se si të veprohet me tutje.

Visar Ymeri – në bazë të situatës së krijuar, janë dy mënyra të financimit të RTK-së. E para ose të vazhdohet të financohet 0.7% nga buxheti i Kosovës ose të kalohet në parapagim, gjë që nuk kanë kaluar. Nëse vendoset të financohet nga buxheti, ne nuk jemi të obliguar të ndajmë 0.7% dhe ne duhet të ndajmë buxhetin në bazë të kërkesave buxhetore që përgatit RTK, dhe të cilat informata tani nuk i kemi. Unë mendojë që ne duhet të veprojmë sipas nenit të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, dhe

financimi i RTK-së në buxhetin e vitit 2015, dhe prapë duhet me trajtue këtë çështje, se përndryshe nuk bënë me e shkel ligjin.

Jakup Krasniqi - po ne duhet të jemi të përgjegjshëm me mbrojt ligjin dhe përkundër asaj që qeveria ka tendenca ndonjëherë me e shkel ligjin, ne si Kuvend duhet ta mbrojmë atë. Ligji RTK-së ka përcaktuar afatin tre vjeçar dhe gjatë kësaj periudhe janë paraparë afatet dhe hapat që duhet ndërmarrë për të gjetur mënyrën e përhershme të financimit dhe kjo nuk ka ndodhur. Me ligjin e buxhetit ne nuk mundemi që të themi se RTK-së i ndajmë mjete siç ka qenë deri më tani dhe kjo të vlejë për gjithë vitin 2015, kur ligji bazik e përcakton afatin e financimit të RTK-së.

Latif Gashi - duke marr parasysh faktin se RTK-në e ka themeluar Kuvendi është obligim i Kuvendit të kujdeset për financimin e tij dhe duhet të ndaj buxhet për funksionimin e tij, në të kundërtën rrezikon të mbyllet. Deri më tani nuk kam dëgjuar, as prej ish kryetarit dhe deputetëve, se ka pasur ndonjë iniciativë për me zgjedh problemin e financimit të RTK-së.

Kryetari - ju lutem unë por flas për teknik dhe rregullim ligjor dhe jo me ndërprerë punën së këtij mediumi. Ne nuk po ja shkurtojmë buxhetin por duhet të rregullojmë nenin, që të jemi në harmoni me ligjin.

Jakup Krasniqi - unë mendoj problemi nuk është me tërë ligjin e RTK-së, por vetëm i një neni që fletë për financimin dhe kjo mund të rregullohet brenda katër muajve të parë të vitit, që të gjindet forma qëndrueshme të financimit të RTK-së, por ligji nuk bënë me u shkel.

Visar Ymeri – nëse RTK vazhdon të financohet nga buxheti i Kosovës, RTK po shëndrrohet në organizatë buxhetore, atëherë ndarja e buxhetit do të bëhet sikurse organizatave tjera buxhetore. Në këtë aspekt, me qenë se po lëvizim në një mekanizëm të tjetër të financimit, nga ajo që ka qenë e parashikuar dhe që do të përfundojë me ligjin e RTK-së, ne nuk jemi të obliguar të ndajmë përqindjen 0.7%, dhe RTK-në duhet të trajtohet sikurse të gjitha organizatat tjera buxhetore.

Bardhyl Meta – ligji ka paraparë që RTK të financohet nga buxheti për një periudhë tre vjeçare dhe gjatë kësaj kohe të gjindet një zgjidhje afatgjate e financimit dhe jo të vazhdohet kështu të financohet me automatizëm. Ne në një pikë duhet të ndajmë buxhetin sipas ligjit, pikën tjetër të ndajmë buxhet për gjithë vitin, dhe gjatë tre apo katër muajve të ardhshëm, të iniciojmë debatin parlamentar për të gjetur formën afatgjate të financimit. Kjo formë nënkupton, që të kërkojmë nga RTK, të dorëzojë raportin financiar, kërkesën buxhetore dhe biznes planin për vitet 2015-2017, ku tregon se cila është gjendja financiare dhe a është i qëndrueshëm apo jo, dhe çfarë ka ngjarë këto tre apo katër vjetët e fundit.

Safete Hadergjonaj – deri më tani, as si Kuvend, as si Qeveri dhe as RTK-ja, nuk kemi punuar sa duhet për të gjetur mënyrën afatgjate të financimit. Janë diskutuar alternativa të ndryshme dhe nuk kemi mundur me ardhur në përfundim, se cila është alternativa më e mirë, që RTK të financohet në një formë tjetër, e jo nga buxheti. Deri sa të financohet nga buxheti, RTK, do të quhet në emër të një apo tjetër subjekti politik. Kështu që, ne duhet që me ligjin e buxhetit, me një paragraf ta rregullojmë që financimi për katër muajt në vazhdim të jetë sipas ligjit të RTK-së, por të jetë edhe një paragraf tjetër, që rregullon ndarjen e mjeteve për vitin fiskal 2015.

Jakup Krasniqi – duhet të lëmë dy format e financimit. Forma e parë që financimi të jetë sipas ligjit të RTK-së dhe brenda katër muajve të ardhshëm mund të zhvillohet debati parlamentar, qoftë me iu vazhdue forma aktuale e financimit prej buxhetit, apo të gjindet një mënyrë tjetër e financimit.

Avdullah Hoti – propozojë të bëjmë dy paragraf: në paragrafin e parë financimi të bëhet sipas ligjit të RTK-së. Në paragrafin e dytë, të lëmë shumën 0.7% dhe mos të përkufizojmë afatet mujore.

Visar Ymeri - unë jam kundër me i nda RTK-së mjete buxhetore 0.7% apo 0.8%, 1% apo 0.5%, pa pasur informacione se si RTK, i ka shpenzuar paratë publike deri më tani, si ka shkuar çështje e punësimit, sa programe i kanë blerë dhe çështjet tjera. Pra, duhet me pas informata për shpenzimin e buxhetit, kërkesën e tyre buxhetore, për të mundur të gjindet forma tjetër e financimit.

Kryetari – RTK është e obliguar me dërgue raportin vjetor të shpenzimeve, që është një tregues për neve dhe mbi bazën e kësaj ne mund të diskutojmë. Unë propozojë që Ministria e Financave, të na sjellë një propozim të ndryshimit të paragrafit 2 të nenit 9 dhe vendosim në takimin e nesërm.

Avdullah Hoti – si ministri e financave do ta rishikojmë paragrafin 2 të nenit 9, dhe të sjellim propozimin në takimin e nesërm, që të jemi në harmoni me ligjin.

Visar Ymeri – sa i përket paragrafit 3 të nenit 9, problemet janë të natyrës politike, por meqë jemi në komision unë po i shfaq disa aspekte teknike dhe ligjore. E para, në mbledhjen e kaluar, kam kërkuar nga ministri që ta kemi një raport për të hyrat edhe shpenzimet mbledhura nga fondi, sepse asnjëherë nuk është raportuar që prej kur është krijuar fondi në buxhet. Çështja e dytë, që kërkojë nga ministri shpjegim, ka të bëjë me përputhshmërinë e këtij neni me ligjet tjera dhe veçanërisht me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Çështja e tretë, ka të bëjë me atë se, me cilin ligj i lejohet përfaqësuesit të BE-së në Kosovë, që të krijoj fond zhvillimor të mirëbesimit duke pasur parasysh se po flasim për të hyra publike. Si rrjedhojë, përmes ligjit të buxhetit, përfaqësuesit të BE-së, për të hyrat publike, po i japim pushtet ekzekutiv, që në fakt është dashtë të jetë këshillues. Çështja e katërt, a ka shpërputhje në mes paragrafit 3 dhe përkufizimit 1.31, që ka të bëjë me fondin zhvillimor të mirëbesimit?

Kryetari – theksoi e kur është bërë ky formulim, jam konsultuar me ministrin e drejtësisë dhe më është thënë se kjo çështje nuk është e diskutueshme sepse është negociuar në Bruksel. Por, tani po e shoh se është e diskutueshme, sepse formulimi nuk është siç ka qenë vitin e kaluar dhe kemi një tekst shtesë, që nuk mund të jetë pjesë e këtij paragrafi, dhe duhet ndahet si paragraf të ri.

Avdullah Hoti – theksoi se edhe unë kam pas dilema për këtë paragraf dhe shpjegimin që e kam marr nga juristët, më është thënë se kjo është rregulluar në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në Kuvendin e Kosovës. Por, ne mund ti bëjmë dy paragraf, në njërin paragraf ta lëmë siç ka qenë më parë dhe në paragrafin tjetër të rregullojmë shtesën që ka ndodhur këtë vit.

Visar Ymeri – nga negociatat që kanë ndodhur në Bruksel, Kuvendi ka ratifikuar vetëm marrëveshjen e prillit që është ratifikuar në muajin qershor, dhe askund nuk përmendet fondi i mirëbesimit. Marrëveshja ndërkombëtare merret me asociacionin dhe me komandantin e policisë për veri, dhe jo me fondin. Ky fond është në shpërputhje me ligjet në Kosovës dhe as nuk është pjesë e marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi, dhe si i tillë është vetëm pjesë e marrëveshjes politike dhe është një nen i kundërligjshëm, nuk duhet me ekzistue në ligjin e buxhetit të Kosovës.

Latif Gashi - kjo temë është diskutuar edhe më herët dhe problemi i komisionit, Kuvendit dhe qeverisë ka qenë që të gjitha hyrat që vijnë nga ato pika doganore të territorit të Kosovës, të derdhen në thesar, dhe pastaj të dedikohen për atë fond zhvillimor të veriut. Këtë fond e kemi pas në shumën zero. Unë kërkojë që tash e tutje të kemi informacione për menaxhimin e këtij fondi, dhe është me interes edhe për popullatën serbe që jeton në atë territor dhe që ju ka nënshtruar sistemit zgjedhor të republikës së Kosovës dhe ligjeve tjera, të jenë të përgjegjshëm.

Agim Krasniqi – sqaroi se vitin e kaluar, fondi ka qenë linjë e veçantë buxhetore, ndërsa me këtë projektligj nuk është linjë e veçantë buxhetore. Fondet që do të vijnë janë planifikuar në ministrinë e financave.

Kryetari – propozim është që në paragrafin 3 të mbetet teksti siç ka qenë vitin e kaluar dhe të shtojmë paragrafin 4, me tekstin që është shtuar këtë vit.

Kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, dy vota Kundër (Visar Ymeri dhe Jakup Krasniqi), asnjë Abstenim, miratojë ndryshimet, në nenin 9, si në vijim:

“Në nenin 9, paragrafi 3, fshihet fjalia e dytë “Bilancet e pashpenzuara nga vitet paraprake në Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit ndahen për vitin fiskal 2015. Mjetet nga Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit do të transferohen tek komunat përfituese pas miratimit të projekteve specifike nga ana e Bordit Menaxhues të këtij Fondi.”

“Në nenin 9, pas paragrafi 3 shtohet paragrafi i ri 4, me tekstin si në vijim: 4. Bilancet e pashpenzuara nga vitet paraprake në Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit ndahen për vitin fiskal 2015. Mjetet nga Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit do të transferohen tek komunat përfituese pas miratimit të projekteve specifike nga ana e Bordit Menaxhues të këtij Fondi. Pavarësisht dispozitave të përcaktuara në nenin 30 të LMFP-së, mjetet e buxhetuara në Thesar për këtë qëllim, do të transferohen në komunat përfituese nga ministri bazuar në miratimin e projekteve specifike nga ana e Bordit Menaxhues të këtij Fondi.

Avdullah Hoti – propozojë që të riformulohet neni 19 dhe të thuhet: Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2015 skadojnë në mesnatën e 31 dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërlidhen me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të komunave apo të ndonjë organizatë tjetër buxhetore të cilës i janë lejuar me këtë ligj, të cilat barten në vitin vijues.

Komisioni, njëzëri miratoi propozimin për riformulimin e nenit 19, me tekstin në vazhdim: “Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2015 skadojnë në mesnatën e 31 dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërlidhen me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të komunave apo të ndonjë organizatë tjetër buxhetore të cilës i janë lejuar me këtë ligj, të cilat barten në vitin vijues.”

Kryetari – propozoi që të bëhet një korrigjim në buxhetin e komunës së Istogu dhe në nën-programin Bujqësi-Istog, në Tabelën 4.2, në projektin me kod 41165 – të fshihet fjala “maxhupit”.

Komisioni njëzëri miratoi propozimin që në buxhetin e Komunës së Istogut, me kod 633, Nën-Programi – Bujqësi-Istog, me kod 470170 në Tabelën 4.2, në projektin me kod 41165, të fshihet fjala: (maxhupit).

Mbledhja përfundoi në orën 15:35

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani